



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr _____ prot

Datë _____.____.2024

VENDIM
Nr. 368, datë 29.07.2024

PËR
KUALIFIKIMIN PËR EMËRIM TË KANDIDATIT TË DIPLOMUAR NË
SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS, Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 29.07.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Ilir Rusi, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar,

VËREN:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, në kushtet kur ai përfshihet në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë në përfundim të vitit akademik 2023-2024, përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, në përputhje me nenin 34, pika 1/1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndyshuar (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), me anë të postës elektronike në datë 02.07.2024, dhe protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me aktin nr.3499 prot., datë 03.07.2024.

2. Po ashtu, z. {...} nuk ka kërkuar të emërohet magjistrat në vitin pasardhës, sikurse lejohet nga neni 32, pika 2, i Ligjit për Statusin, sipas të cilit: “2. *I diplomuari që përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për shkaqe të justifikuara, jo më vonë se dy javë nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, mund të kërkojë që të emërohet si magjistrat në vitin pasardhës*”.

3. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, në përputhje me nenin 34, pika 1, të Ligjit për Statusin, si dhe Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për

rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 14, datë 18.01.2024, vendosi *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2023-2024*, duke caktuar relatorin për çdo kandidat, ku në bazë të shortit, për kandidatin z. {...}, si relator u caktua z. Ilir Rusi.

4. Më datë 22.01.2024, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit treditor, kandidati z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Më datë 29.01.2024, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

7. Brenda afatit pesëditor, kandidati z. {...}, depozitoi në zyrën e protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor formularët dhe autorizimet përkatëse.

8. Gjatë procedurës së verifikimit, më datë 29.01.2024, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

9. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KUSHTET DHE KRITERET LIGJORE TË EMËRIMIT SI MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR

A. Për kushtet e emërimit

10. Neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: *“1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. 2. Kritere të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj”.*

11. Nga kjo dispozitë kushtetuese identifikohen dy kushte emërimi si magjistrat: *“shtetësia shqiptare”* dhe *“përfundimi i formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës”.*

A.1 Për kushtin e shtetësisë shqiptare

12. “Shtetësia shqiptare” është përcaktuar si kriter kandidimi për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, referuar nenit 28, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin. Për këtë shkak, ajo është verifikuar në rastin e kualifikimit të z. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2021 - 2022, sipas Vendimit nr. 321, datë 21.07.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

13. Pavarësisht kësaj, sa kohë kjo rrethanë është e ndryshueshme, në funksion të verifikimit të kushtit të emërimit si magjistrat, profili gjyqtar, të z. {...}, kjo rrethanë u verifikua sërish. Gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 26.04.2024, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas të dhënave elektronike vënë në dispozicion nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare, duke përmbushur kështu këtë kusht emërimi si magjistrat, profili gjyqtar.

A.1 Për kushtin e përfundimit të formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës

14. Siç u parashtrua, neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe neni 35, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit të Statusit¹, për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, kërkojnë përfundimin e formimit fillestar/diplomimin në Shkollën e Magjistraturës.

15. Bazuar në Vendimin nr. 23, datë 28.06.2024 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë me anë të postës elektronike dhe regjistruar në Këshill me aktin nr.

¹ “1. I diplomuari emërohet magjistrat ...”.

3499 prot., datë 03.07.2024, konstatohet z. {...} ka përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës Tetor 2021- Qershor 2024 dhe në përfundim të vitit akademik 2023-2024 është diplomuar magjistrat, profili gjyqtar, duke përmbushur kështu këtë kusht emërimi si magjistrat, profili gjyqtar.

B. Për kriteret e emërimit

16. Neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar se gjyqtarët emërohen pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit, ndërkohë që kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj. Në bazë të këtij autorizimi kushtetues, Ligji për Statusin, në nenin 35, ka përcaktuar kriteret e emërimit të kandidatit magjistrat të diplomuar.

B.1 Për kriterin e vlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës

17. Neni 35, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkojnë që kandidati të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme, si dhe të jetë vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar.

18. Bazuar në dokumentacionin e kandidatit {...}, përcjellë me anë të postës elektronike dhe regjistruar në Këshill me aktin nr. 3499, datë 03.07.2024, të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se kandidati z. {...} është diplomuar magjistrat, profili gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2023-2024:

- a) me 88.76% të pikëve, pra *“është diplomuar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme”*;
- b) është vlerësuar me 598 pikë, domethënë “Mirë”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra *“është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar”*.

19. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z. {...} plotëson këto kriteret të emërimit si magjistrat, profili gjyqtar.

B.2 Për kriterin e pasurisë

20. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkon që kandidati të ketë kaluar sërish verifikimin e pasurisë, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

21. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 2. ... Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë ..., nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ..., organet e administratës tatimore dhe doganore, ..., si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. ... 4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë ... kur: a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit; ...”.

22. Në rastin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, z. {...} i është nënshtruar verifikimit të pasurisë, në përfundim të cilit është konkluduar se ai plotësonte këtë kriter, referuar Vendimit nr. 321, datë 21.07.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

23. Për verifikimin sërish të kriterit të pasurisë për kandidatin z. {...} u kërkuar raportim nga organet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, i ndryshuar, dhe konkretisht me shkresën nr. 611 prot., datë 29.01.2024 “Kërkesë për informacion lidhur me kandidatët për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës, në përfundim të vitit akademik 2023-2024” u kërkuar përfundimi sa më parë i kontrollit të plotë të verifikimit e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratat e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës në përfundim të vitit akademik 2023-2024, sipas listë emërore, ndër ta edhe për z. {...}.

24. Me shkresën nr. 752/1 prot., datë 22.02.2024, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. 611/9 prot., datë 23.02.2024, me lëndë “Mbi kandidatin z. {...}”, ILDKPKI informon se afati i fundit për të depozituar deklaratën e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë ka qenë data 19.02.2024, dhe nga të dhënat e administruara, z. {...} ka plotësuar dhe përfunduar në formë elektronike deklaratën e pasurisë më datë 20.02.2024. Gjithashtu z. {...} ka dorëzuar në formë shkresore deklaratën në datë 21.02.2024 duke parashtruar shkaqet e kësaj vonese. Në këto kushte ILDKPKI, kërkoi qëndimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e procesit të verifikimit të interesave privatë për kandidatin.

25. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me anë të shkresës “kthim përgjigje” nr. 611/20 prot., datë 05.03.2024, lidhur me shkaqet e vonesës dhe kufizimet në plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës së pasurisë, duke marrë në konsideratë situatën familjare të kandidatit, sugjeroi vijimin e procesit të verifikimit të interesave privatë për kandidatin z. {...}.

26. Në vijim, me aktin nr. 59/23 prot., datë 27.05.2024, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. 611/74 prot., datë 29.05.2024, ILDKPKI dërgoi “Aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë {...}, që kandidon për t’u emëruar Magjistrat, profili Gjyqtar”.

27. Sipas Raportit të ILDKPKI-së nr. 59/23 prot., datë 27.05.2024, kandidati z. {...} në datë 20.02.2024 ka dorëzuar pranë ILDKPKI Deklaratën e Pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë/ për t’u emëruar Magjistrat, profili Gjyqtar.

28. Po ashtu, sipas Raportit të ILDKPKI-së, nga ky i fundit janë kryer kontrollet e plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruar nga kandidati, për periudhën mbas kontrollit të plotë pasuror të kryer për të si kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) **deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;**
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

29. Me anë të postës elektronike në datë 03.06.2024, kandidatit iu kërkuan sqarime lidhur me konstatimin e ILDKPKI : **deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,** duke i caktuar një afat 5-ditor për dhënien e sqarimeve. Kandidati konfirmoi marrjen dijeni në datë 04.06.2024.

29.1. Në datë 10.06.2024, me anë të postës elektronike si dhe nëpërmjet depozitimit në Zyrën e Protokollit, administruar në Këshill me aktin nr. 611/77 prot., datë 10.06.2024, kandidati paraqiti sqarimet e tij lidhur me sa ishte kërkuar nga ana e Relatorit, në të cilat parashtron se: “...Unë, në cilësinë e kandidatit dhe të subjektit ndaj të cilit është kryer kjo procedurë verifikimi, jam njoftuar me emailin e datës 04.06.2023 për rezultatin e mësipërm dhe me kërkohet që të japë sqarimet përkatëse në lidhje me përfundimet e këtij raporti.

Në leximin që unë i kam bërë këtij raporti të hartuar nga ana e ILDKPKI konstatoj se deklarimi i pasaktë (nëse nuk gabohem) që referon ILDKPKI qëndron në faktin se unë kam një tepricë në pasurinë time prej 149.000 mijë lekësh.

Nga verifikimi që kam bërë, duke patur parasysh që burimi im i vetëm i të ardhurave gjatë këtij tre vjeçari studimesh në Shkollën e Magjistraturës ka qenë bursa e përfituar pranë kësaj

shkolle, me rezulton që teprica për të cilën bëhet fjalë në raportin ILDKPKI është pjesë e shumës prej 194.660 mije lekësh, që buron prej rivlerësimit të pagave të magjistratëve bërë nga ana e Gjykatës Kushtetuese me anë të vendimit nr. 35/2022.

Si rezultat i këtij vendimi edhe bursa e studentëve të Shkollës së Magjistraturës pësoi rritje. Në këto kushte, Shkolla e Magjistraturës ka bërë rivlerësimin e bursës në bazë të këtij vendimi dhe ka alokuar dhe shtesat përkatëse që rrjedhin prej tij. Si rezultat i këtyre shtesave unë deri tani kam marrë një shumë prej 194.660 mije lekësh, dhe jam në pritje të marrjes edhe të një kësti tjetër.

Një pjesë e kësaj shume, ku figuron edhe vlera prej 149.000 mije lekësh, është hedhur nga ana e Shkollës sipas shkresës me nr. 863 prot date 07.06.2024, në kolonën “diferencë burse”, ndërkohë unë jam në pritje të hedhjes edhe të këstit tjetër të shumës totale gjatë muajit Qershor 2024, sipas informacioneve të ardhura nga vet shkolla.

Pra, burimi im i të ardhurave është plotësisht i ligjshëm dhe i saktë dhe nuk kam kryer deklaram të pasaktë. Kjo shumë e cila figuron në llogaritë e mia është hedhur nga vetë shkolla pas ndryshimeve që prodhoi vendimi i Gjykatës Kushtetuese mbi rivlerësimin që iu bë pagave të magjistratëve.

Për të vërtetuar këtë pretendim, sot më datë 10.06.2024, kam depozituar në protokollin e KLGJ edhe shkresën me nr.863 prot datë 07.06.2024, ku figurojnë edhe derdhjet përkatëse në kolonën “Diferencë Burse”, shkresë e cila vërteton pretendimin tim.

30. Me shkresën nr. 3066 prot., datë 05.06.2024, drejtuar Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor u kërkua:

- i) informacion mbi arsyet me anë të cilave është arritur në përfundimin se **deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin**;
- ii) kopje e dokumentacionit të administruar gjatë kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë për z. {...}, që kandidon për t’u emëruar Magjistrat, profili gjyqtar.

30.1. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me anë të shkresës “Kthim përgjigje” nr. 752/20 prot., datë 14.06.2024, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. 3066/1 prot., datë 18.06.2024, lidhur me arsyet me anë të të cilave është arritur në përfundimin se deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, në Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë, të përcjellë me shkresën nr. 59/23 prot., datë 27.05.2024, informon se janë evidentuar problematikat e kandidatit z. {...}, konkretisht:

- ❖ Kandidati ka deklaruar adresën e banimit, e cila i përket apartamentit në Tiranë, me nr. pasurie 7/630+8-1, në b/pronësi me b/shorten. (dhuruar nga babai i saj) dhe ka sqaruar arsyen e mosdeklarimit si aset.
- ✓ Apartamenti në Rr. “Sami Frashëri”, Tiranë, është trajtuar në deklaratën e kandidatit të dt.18.6.2021.

- ❖ Kandidati nuk ka deklaruar pjesën takuese të garazhit me sipërfaqe 21.06 m², në Rr “Sami Frashëri”, Tiranë, që sipas sqarimeve të paraqitura, është blerë duke pakësuar llogarinë bankare të b/shortes së tij në Credins Bank, e cila në datë 18.06.2021, kur kandidati ka paraqitur deklaratën e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, ka pasur gjendje shumë 92.000 Euro.
- ❖ Duke qenë në proces divorci, si dhe nisur nga fakti që b/shortja gjendet në kërkim ndërkombëtar, kandidati ka paraqitur sqarimin bashkëlidhur deklaratës, për arsyet e mosplotësisë të formularit të deklarimit nga ana e saj, si dhe të kufizimeve në deklarimin e tij. Kandidati nuk ka deklaruar pjesën takuese të tij, në pasuritë në b/pronësi me b/shorten dhe as ajo pasuritë në emër të saj, për të cilat pjesa takuese do vendoset nga gjykata.
Krahasuar me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë e dt.18.6.2021, përveç apartamentit në Rr “Sami Frashëri”, rezultoi në b/pronësi edhe automjeti tip Tiguan, blerë pjesërisht me qira financiare, si dhe garazhi i konfirmuar nga ASHK, për të cilin rezultoi se kontrata është nënshkruar nga kandidati dhe b/shortja.

Bashkëlidhur përgjigjes, ILDKPKI dërgoi edhe kopje të dokumentacionit të administruar gjatë kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Private të kandidatit {...}.

31. Me anë të postës elektronike në datë 20.06.2024, kandidatit iu kërkuan sqarime shtesë lidhur me konstatimet e ILDKPKI dhe të cituara në kthim përgjigjen nr. 752/20 prot., datë 14.06.2024, duke i caktuar një afat 5-ditor për dhënien e sqarimeve.

31.1. Me emailin e datës 23.06.2024, me lëndë "Sqarimet shtesë" kandidati paraqiti sqarimet dhe shpjegimet e tij lidhur me konstatimet e ILDKPKI, si vijon: “...në këtë raport, ILDKP ka arritur në përfundimin se unë kam bërë deklaram të pasaktë për disa komponentë. Nuk jam dakord me qëndrimin e ILDKP në lidhje me këtë rezultat, ndër të tjera për këto arsye:

- 1. Kandidati ka deklaruar adresën e banimit, e cila i përket apartamentit në Tiranë, me nr. Pasurie 7/630+8-1, në bashkëpronësi me ish bashkëshorten (dhuruar nga babai i saj) dhe ka sqaruar arsyen e mosdeklarimit si aset.**
Apartamenti në fjalë, me adresë Rr. “Sami Frashëri”, Tiranë, është trajtuar në deklaratën e kandidatit të dt.18.06.2021.

Në përgjigje të këtij përfundimi, unë deklaroj se apartamentin në fjalë e kam deklaruar njëherë, ashtu sikurse deklaron dhe vet ILDKP, në deklaratën parë të datës 18.06.2021.

Në deklaratën e dytë kam tentuar ta deklaroj por sistemi nuk e merrte. Megjithatë këtë ja kam shprehur si shqetësim nëpunësit përgjegjës për dosjen time, duke e vënë në dijeni se ky aset është deklaruar njëherë nga ana ime në deklaratën e parë dhe çdo gjë ka qenë në rregull.

Nuk është një aset i krijuar rishtazi për të cilin unë nuk kam bërë deklarime, por është i deklaruar prej meje që në fillim. Fakti që nuk e kam ngarkuar në sistem, pasi kam dashur ta deklaroj, ka qenë si rezultat i mosfunksionimit të sistemit dhe këtë fakt e kam bërë të ditur. Në këto kushte, nuk arrij të kuptoj se ku qëndron pasaktësia në deklarim, kur ky aset është deklaruar prej meje që në vitin 2021, dhe është verifikuar dhe si burim krijimi dhe si ligjshmëri burimi.

Në këto kushte vlerësoj se nuk jam përpara pasaktësisë në deklarim, pasi nuk kam gabuar në deklarimin e asgjëje, është thjesht një aset i cili është deklaruar më parë tashmë prej 3 vjetësh, dhe nuk kam patur asgjë të re se çfarë të deklaroj në lidhje me të.

- 2. Kandidati nuk ka deklaruar pjesën e tij takuese të garazhit me sipërfaqe 21.06 m², në Rrugën “Sami Frashëri, Tiranë, që sipas sqarimeve të paraqitura është blerë duke pakësuar llogarinë bankare të ish bashkëshortes së tij në Bankën Credins, e cila në datë 18.06.2021, kur kandidati ka paraqitur deklaratën për pozicione të ndryshme në institucione e sistemit të drejtësisë ka pasur gjendje 92.000 euro.**

Atëherë, në lidhje me këtë aset, sikurse e kam deklaruar edhe pranë ILDKP në sqarimet që kam dhënë në lidhje me të, kam sqaruar se ky është blerë nga ana e ish bashkëshortes time me anë të fondeve të siguruara nga shitja e një apartamenti që i ati i saj i kishte dhënë.

Në bazë të nenit 74 të Kodit të Familjes thuhet se:

Pasuria vetjake Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është:

a) pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi;

b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë;

c) pasuritë e përdorimit ngushtësisht vetjak të secilit bashkëshort dhe pasuritë e fituara si aksesori të pasurisë vetjake;

ç) mjetet e nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit të njërit prej bashkëshortëve, përveç atyre që janë caktuar për administrimin e një veprimtarie tregtare;

d) pasuria e fituar nga shpërblimi i dëmit vetjak, me përjashtim të të ardhurave që rrjedhin nga pensioni i fituar për shkak të humbjes së pjesshme ose të plotë të aftësisë për punë;

dh) pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura...

Sikurse e kam sqaruar edhe ne ILDKP, ky garazh është blerë nga ana e ish bashkëshortes time me të ardhurat e fituara nga shitja e një pasurie tjetër të paluajtshme të dhuruar nga i ati i saj. Kjo pasuri e shitur për të blerë të renë ishte vetjake. Ky transaksion ekziston si gjurmë në Bankën Credins dhe ILDKP e ka si informacion. Duke qenë se një send vetjak është shitur dhe një send tjetër është blerë me lekët e shitjes së sendit vetjak, automatikisht në bazë të nenit 74 pika (dh) edhe ky send i ri i blerë është pasuri vetjake.

Duke qenë vetjak dhe sendi i ri – pra garazhi objekt verifikimi në rastin konkret – detyrimi për ta deklaruar e ka patur ish bashkëshortja ime si person i lidhur.

Përderisa ajo është në kërkim ndërkombëtar nga policia dhe është e strehuar në Belgjikë ku Interpoli ka arritur ta lokalizojë, ajo nuk ka mundur dhe nuk do të deklarojë, për shkak edhe të konflikteve që ka me mua.

Këto sqarime unë i kam dhënë pranë ILDKP, por ndërkohë kjo e fundit shprehet që unë si kandidat duhej të deklaroja pjesën time takuese mbi këtë send, kur, sikurse ju shpjegova dhe më lart, unë nuk kam asnjë pjese takuese mbi këtë send pasi është vetjak i bashkëshortes dhe detyrimin e ka pas ajo për ta deklaruar.

ILDKP këtë argumentim timin nuk e ka pranuar dhe shprehet se ka pasaktësi në deklaram, kur ndërkohë unë kam qenë i ndërgjegjshëm për mosdeklarimin pasi kam vlerësuar se nuk kam asnjë të drejtë pronësi mbi të. Për pasojë, duke e konsideruar si pasuri vetjake të ish bashkëshortes time mendoj se detyrimin ligjor për ta deklaruar e ka patur dhe e ka ajo.

Kjo nuk ka të bëjë as me harresë nga ana ime dhe as me ndonjë pasaktësi pasi ky send figuron i regjistruar në ASHK, dhe megjithëse në emrin e të dyve për efekt martesë, sikurse thashë, është pasuri vetjake e ish bashkëshortes. Kjo ka qenë arsyeja që unë nuk e kam deklaruar vetë, përderisa detyrimin për ta deklaruar e ka ish bashkëshortja.

Në këtë pikë, nuk konsideroj se kam bërë deklaram të pasaktë, sepse kam konsideruar se për pasurinë vetjake duhet të deklaroj titullari i saj. Megjithatë, ky send si për nga krijimi dhe burimi i krijimit të tij është gjithçka plotësisht e ligjshme dhe e verifikueshme.

3. Në lidhje me mjetin tip Tiguan, Volksvagen, që ILDKP e konsideron në bashkëpronësi.

Edhe në lidhje me këtë aset kam deklaruar njëherë në deklaratën vitit 2021, ku kam sqaruar pozicionin tim në lidhje me këtë send, sqarime të cilat janë pranuar si nga KLGJ e asaj kohe dhe nga drejtuesit e ILDKP të asaj kohe. Megjithatë sqaroj se:

Për mjetin Tiguan, Volksvagen, po të shikohet kontrata, gjë të cilën e ka dhe ILDKP, unë jam dorëzues në atë kontratë dhe jo bashkëpronar. Mjeti është blerë nga ish bashkëshortja ime me financime të të atit të saj. Ky mjet aktualisht, në dijeninë time pasi nuk e posedoj, është akoma në pronësi të Bankës Credins, pasi kontrata e leasingut e lidhur me këtë bankë për blerjen e tij nuk është mbyllur akoma, pasi ish bashkëshortja ime duhet të paraqitet si pronare e vetme e këtij asemi për të bërë formalitetet e mbylljes së kontratës, ndërkohë që shuma totale tashmë është paguar nga i ati i saj dhe makina përdoret prej këtij të fundit.

Po të isha bashkëpronar në këtë mjet, atëherë banka në fjalë fare mirë mund të më thërriste mua për t'i dhënë fund kontratës në cilësinë e bashkëpronarit, por nuk e ka bërë. Dhe me të drejtë, pasi unë jam dorëzues dhe jo bashkëpronarë. Këtë kontratë po ja u nis bashkëlidhur këtij emaili.

Si përfundim, edhe ky aset është deklaruar prej meje në deklaratën e 2021 dhe nuk arrij të kuptoj se pse ILDKP i rikthehet një asemi që tashmë është verifikuar njëherë dhe është certifikuar si i ligjshëm në krijim, në deklaram dhe në burim të ardhurash... ”

Bashkëlidhur emailit me sqarimet shtesë, gjendet Kontrata e Qirasë Financiare nr. 3274 rep, dhe nr. 1447 kol, datë 29.06.2018, me palë shoqërinë aksionere “BANKA CREDINS” SH.A në cilësinë e “Qiradhënësit”, znj. Flavia Astrit {...} në cilësinë e “Qiramarrësit” dhe z. Suzan

Dalip {...} në cilësinë e “Dorëzanësit”, me objekt automjetin e markës Volkswagen, modeli Tiguan Highline 2.0 TSI BMT motion DSG, me numër.shasie WVGZZZZ5NZJW441250.

32. Për verifikimin sërish të kriterit të pasurisë për kandidatin z. {...} iu kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

32.1. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me shkresën nr. 2016/1 prot., datë 12.02.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 611/18 prot., datë 23.02.2024, ku për kandidatin Suzan {...}, nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare.

32.2. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me shkresën nr. 2248/2 prot., datë 06.03.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 611/21 prot., datë 07.03.2024, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

33. Nga verifikimi sërish i kriterit të pasurisë për kandidatin z. {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të tij. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidati, të formularit të deklaratës së pasurisë;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidati, të nënshkruara, të autorizimeve të kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) burimet financiare të kandidatit dhe justifikimin ose jo të pasurisë së stij;
- ç) plotësinë, vërtetësinë dhe saktësinë ose jo, të deklaratimit të pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar.

B.3 Për kriterin e figurës

34. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkon që kandidati të këtë kaluar sërish verifikimin e figurës, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

35. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 2. ... *Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e ... figurës ..., prokuroria, gjykata, ..., Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, ..., si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. ... 4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të ... figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në*

krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që çenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ...”.

36. Në rastin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, z. {...} i është nënshtruar verifikimit të figurës, në përfundim të cilit është konkluduar se ai plotësonte këtë kriter, referuar Vendimit nr. 321, datë 21.07.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

37. Për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidatin z. {...} u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, i ndryshuar.

38. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit z. {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që çenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

39. Nga raportimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas shkresës nr. 127/1 prot., datë 16.02.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 611/17 prot., datë 19.02.2024, nuk rezultoi ndonjë informacion i vlefshëm për qëllimet e verifikimit për kandidatin z. {...}.

40. Për kandidatin z. {...}, në kushtet kur ai, në momentin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ka përmbushur detyrimet sipas Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe i është nënshtruar kontrollit sipas këtij ligji, referuar për këtë Vendimit nr. 321, datë 21.07.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në funksion të verifikimit sërish të figurës për të, u kërkua informacion i përditësuar nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo e fundit, me shkresën nr. 610/5 prot., datë 29.02.2024, për kandidatin z. {...} informoi se: *-ka dorëzuar Formularin e Vetëdeklarimit me datë 07.06.2021;-formulari është regjistruar me numrin unik 000596 ;-vetëdeklarimi është publikuar në faqen zyrtare web të KLGJ-së;- në formular nuk ka deklaruar ndryshime;-Sektori i Gjendjes Civile personi rezulton se (nuk ka ndryshime ose korrigjime në gjeneralitete); -Sektori i Gjendjes Gjyqësore, personi rezulton (i padënuar) nga gjykatat penale shqiptare; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.*

41. Për verifikimin sërish të figurës së kandidatit z. {...} u kërkua informacion nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila, me shkresën nr. 166/15 prot., datë 25.03.2024, protokolluar në Këshill me nr. 611/26 prot., datë 27.03.2024, ka dërguar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor

informacionin e përcjellë nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. 2904 prot, datë 29.02.2024 informon si vijon: “... Përsa i përket shtetasit {...}{...}, rezulton të jetë regjistruar kallëzimi penal nr. 12433 viti 2022, referuar “Për vlerësim”, marrë vendim për mosfillim të procedimit penal me datë 22.12.2022...”

42. Me shkresën nr. 611/33 prot., datë 04.04.2024 drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, (Dhoma Penale) u kërkua informacion dhe dokumentacion lidhur me faktin nëse ushtruar e drejta e ankimit nga palët ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 22.12.2022 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe nëse po, vijueshmëria e tij në gjykatë.

42.1 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me anë të shkresës nr. 1170/1 prot., datë 15.04.2024, protokolluar në Këshill me nr. 611/37 prot., datë 15.04.2024, dërgoi informacionin e kërkuar, nga ku rezulton se: “...pas verifikimeve të bëra në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Penale të Gjykatës për 2022 e në vijim, në lidhje me materialin kallëzues Nr.12433 të vitit 2022, nuk rezulton e regjistruar asnjë kërkesë me objekt “Kundërshtim të vendimit të mosfillimit”.

43. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është administruar shkresa e shtetasës Flavia Kuqi ({...}), protokolluar në Këshill me nr. 3019 prot., datë 24.05.2023, (vënë në dispozicion të Relatorit në datë 04.06.2024) drejtuar Shkollës së Magjistraturës dhe për dijeni Këshillit të Lartë Gjyqësor. Shkresës i janë bashkëlidhur edhe disa dokumenta shtesë si: i) Deklaratë Noteriale nr. 268 rep, dhe 129 kol, datë 27.01.2023 e shtetasit Olsen Shehu; ii) Deklaratë Noteriale nr. 455 rep, dhe 203 kol, datë 10.02.2023 e shtetasës Lirije Kuqi; iii) Vërtetim njësia me origjinalin nr. 788 Rep., datë 04.03.2023; iv) Deklaratë Noteriale nr. 248 rep, dhe 114 kol, datë 25.01.2023 e shtetasës Majlinda Sota; v) Kopje të dosjes së kallëzimit penal ; vi) Kopje të dosjes së procesit gjyqësor; vii) 1 (një) fletë kopje procesverbali.

43.1. Me emailin e datës 10.06.2024, kandidati u njoftua mbi shkresën e shtetasës Flavia Kuqi ({...}) së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur dhe bazuar në parashikimet e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, iu bë me dije se ka të drejtën për paraqitur shpjegimet lidhur me shkresën e sipërcituar dhe dokumentacionin bashkëlidhur saj, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit. Kandidati konfirmoi marrjen dijeni në datë 12.06.2024.

43.2. Me anë të postës elektronike në datë 18.06.2024 si dhe nëpërmjet depozitimit në Zyrën e Protokollit të Këshillit, administruar me aktin nr.3283, datë 18.06.2024, kandidati paraqiti shpjegimet e tij lidhur me shkresën e {...} ({...}) dhe dokumentacionin bashkëlidhur. Në këto shpjegime kandidati parashtron: “...Me anë të emalit të datës 10.06.2024, për të cilin mora dijeni më datë 12.06.2024, po ju sqaroj si më poshtë:

Unë me ish bashkëshorten time, znj. {...} {...} jemi në një proces divorci prej dy vjetësh tashmë. Për shkak të konsumit të marrëdhënies tonë dhe mosmarrëveshjeve që kishim vendosëm që t'i jepnim fund marrëdhënies duke iu drejtuar Gjykatës së Tiranës me kërkesën përkatëse për zgjidhje martese. Por, bashkë me kërkesën për divorc, ish-bashkëshortja ime filloi një fushatë shpifjesh dhe akuzash të pavërteta ndaj meje të cilat për qellim kishin dëmtimin e reputacionin tim dhe përjashtimin tim nga Shkolla e Magjistraturës në mënyrë definitive, duke fabrikuar histori të paqena dhe duke paguar njerëz për të shpifur gjëra të pavërteta ndaj meje, të cilat, mundësisht, te mbylleshin, pse jo, edhe me një dënim penal ndaj meje. Konkretisht, duke filluar nga Shkurti 2022 në nuk jetonim më së bashku, pasi ish bashkëshortja braktisi banesën familjare dhe iku të jetonte në shtëpi me qira. Unë bashkë me dy fëmijët e mitur vazhduam të jetonim në banesën familjare.

Duke qene se unë isha ndërmjet kandidateve që vettingun në hyrje e kalova me vonesë, në Korrik 2022, në Shtator 2022 duhej të kaloja provimet e vitit të parë të shkollës. Pasi ra në dijeni të këtij fakti, ish bashkëshortja bashke me avokaten e saj të asaj kohe kërkon një takim me mua me qëllim « zgjidhjen me pajtim » të divorcit mes nesh. Në takimin e supozuar për pajtim erdhi vetëm avokatja e ish bashkëshortes, e cila pasi me vuri në dijeni se si ish bashkëshortja më kishte ndjekur me detektiv privat dhe kishte, gjasme, prova komprometuese ndaj meje, më propozoi një marrëveshje në kushte shantazhi, të cilën unë nëse nuk e pranoja, atëherë të gjitha « provat komprometuese » që ato kishin do te përfundonin në televizionet kombëtare dhe unë do të diskreditoheja si njeri. Për këtë shkak unë paraqita kallëzim ne polici ndaj avokates Bitilida Mehmeti (avokatja në fjalë e ish bashkëshortes), procedim i cili më pas u pushua për mungesë provash. Duke mos dashur të rëndoja më tepër nga ç ' ishte situatën, unë vendosa të mos bëja ankim ndaj atij vendimi të pushimit me shpresën se gjërat do të mbylleshin aty.

Më pas, duke qenë se rruga e shantazhit nuk funksionoi, ish bashkëshortja tentoi rrugën e Urdhrit të Mbrojtjes, me argumentin e « dhunës në familje ». Kështu, pas një kallëzimi në polici nga ana e ish bashkëshortes për mua për dhunë në familje, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Dhoma Civile, u vu në lëvizje me kërkesën për lëshim të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në seancën e datës 20.09.2022 ish bashkëshortja ime, si palë kërkuese, nuk arriti të provonte dhunën në familje pasi dhunë nuk ka patur asnjëherë. Jo vetëm kaq, por ajo paraqiti të gjitha deklaratat notoriale të personave që ajo kishte marrë, ku disa prej këtyre personave (e ëma e saj dhe ish pastruesja jonë) erdhën dhe dëshmuan ne gjyq, kuptohet variantin e përpunuar prej kohësh dhe të gënjeshtër sikur unë isha njeri i dhunshëm dhe imoral, që bëja jetë të shturur dhe që nuk kujdesesha për fëmijët dhe dhunoja atë; gjithçka një shpifje e ulët vetëm për të më dëmtuar dhe për të më marrë fëmijët.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me anë të vendimit nr.4660 datë 20.09.2022 vendosi rrëzimin e kërkesës për lëshim të urdhrit të mbrojtjes. Ky vendim u la në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit me anë të vendimit me nr.3 datë 17.01.2023. Me këtë vendim merr fund historia fiktive e urdhrit të mbrojtjes. Ndërkohë, Prokuroria e Tiranës me anë të vendimit datë 22.12.2022 vendosi pushimin e çështjes në ngarkimin tim për dhunë në familje.

Duke parë që në rrugë normale, ligjore, ish bashkëshortja nuk po arrinte qëllimet që i kishte venë vetes, pra të më dëmtonte duke më akuzuar për gjëra të paqena, ajo dërgon më datë 24.05.2023 një letër pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ambasadës Amerikane dhe Shkollës së Magjistraturës, me përmbajtje thellësisht denigruese ndaj meje, duke mashtruar në lidhje

me figurën time, si një njeri i papërshtatshëm për të qenë gjyqtar, si një njeri me vese të drogës dhe alkoolit, që bëja një jetë të shturur dhe të tjera shpifje banale.

Me anë të shkresës me nr.388/2 prot datë 13.11.2023 Shkolla e Magjistraturës vendos në dijeni ish bashkëshorten time në lidhje me akuzat e saj se me qëllim vërtetimin e tyre, duke gene se ato kanë karakter penal, ajo duhej t'i drejtohej prokurorisë për të referuar faktet që dispononte. Deri më sot, asnjë kallëzim nuk është depozituar nga ana e ish bashkëshortes ndaj meje në lidhje me këto fakte në Prokurorinë e Tiranës.

Më tej, më datë 10.07.2023 ish bashkëshortja ime, në një gjest aspak human, rrëmben fëmijët dhe largohet drejt Belgjikës për të kërkuar azil. Me t'u vendosur në dijeni të këtij fakti, unë kam bërë denoncimet përkatëse në prokurori ku akuza e ngritur për zonjën është « marrje e padrejte e fëmijëve » dhe « keqtrajtim te miturish ». Sot, unë jam në pritje të riatdhesimit të fëmijëve të mi dhe kam nisur procedurat e nevojshme për këtë qëllim në shtetin Belg, me ndihmën e Ministrisë së Drejtësisë Shqiptare, në bazë të Konventës së Hagës të vitit 1980 “Për rrëmbimin ndërkombëtarë të fëmijëve dhe aspektet civile të lidhura me to”.

Unë i kuptoj shqetësimet tuaja dhe të KLGJ në lidhje me pretendimet e ish bashkëshortes time, për sa i përket të gjithë pretendimeve të bëra nga ana e saj në letrën e dërguar pranë jush, si dhe të “deklarimeve noteriale” që disa persona të paguar prej saj kanë bërë ndaj meje.

Fillimisht më duhet t'ju them se të gjitha deklaratimet e bëra nga këta persona si dhe përpjekjet e saj për të patur urdhër mbrojtje, apo dhe letra e dërguar pranë jush «si shqetësim qytetar » për figurën time si magjistrat i ardhshëm, nuk janë veçse një përpjekje mjerane nga ana e ish bashkëshortes për të marrë azil në shtetin belg, duke e shfaqur veten pranë atij shteti si një njeri që ka bërë të gjitha përpjekjet për të gjetur drejtësi në Shqipëri ndaj perkusionit të bërë nga i shoqi, por korrupsioni dhe influenza ime në shtetin Shqiptar është aq e madhe sa që unë, falë kësaj influence, kam arritur të diktoj të gjitha vendimmarrjet e institucioneve përkatëse në lidhje me këtë çështje.

Ish bashkëshortja është munduar ta paraqesë veten si një e persekutuar në Shqipëri për shkak të pozicionit Tim si magjistrat i ardhshëm, dhe në këtë drejtim, unë si një njeri me influenza në nivele të larta paskërkam ndikuar në vendimmarrje gjykatash dhe prokurorish, me qëllimin e vetëm persekutimin e zonjës në fjalë dhe keqtrajtimin e saj.

Më lejoni t'ju them se çdo pretendim i saj në lidhje me mua, për sa i përket figurës time morale, njerëzore, profesionale apo qytetare, nuk është veçse një shpifje e ulët, një mashtrim ordiner, vetëm e vetëm për të sabotuar gjithë karrierën time të ardhshme si gjyqtar; dhe në pamundësi të arritjes së këtij objektivit, marrjen e azilit në Belgjikë.

Në asnjë moment zonja në fjalë nuk ka bërë dhe përpjekjen me minimale për sqarim e këtyre rrethanave të pretenduara prej saj me anë të organit të prokurorisë, duke depozituar fare mirë pranë këtij të fundit një kallëzim penal për të gjitha pretendimet që ajo ka. Kjo gjë është bërë me qëllim të caktuar nga ana e saj, pasi ajo e ka ditur fare mirë që gjithçka që thoshte ishte e pavërtetë, por duheshin mbajtur të tilla për krijimin e alibisë së viktimës në sytë e autoriteteve belge në mënyrë që të përftojë azil në atë shtet, dhe për asgjë tjetër.

Unë që në fillim kur jam vënë në dijeni të këtyre pretendimeve kam patur mundësi për të bërë kallëzim ndaj ish bashkëshortes time për shpifje, por kam refuzuar ta bëj një gjë të tillë. Arsyeja se pse ka qenë thjesht fakti që nuk kam dashur të nderë më shumë nga çka qenë situatën mes nesh, dhe përpos kësaj, kam dashur që kjo histori të mbyllet sa më parë, pa prodhuar më tepër kosto për fëmijët tanë dhe për vete.

Në këto kushte, çdo pretendim i saj në këtë drejtim është vetëm një shpifje dhe asgjë me shumë, e cila nuk meriton asnjë lloj vëmendje në gjykimin tim.

Bashkëlidhur shpjegimeve të dërguara me anë të postës elektronike, kandidati z. {...} paraqiti edhe dokumentacionin si vijon:

i) Vendim nr. 3 (30-2023-46) datë 17.01.2023, i Gjykatës së Apelit Tiranë, me paditës Flavia {...}, dhe të paditur {...}, me objekt “*Lëshimi i urdhrin të mbrojtjes*”, nga përmbajtja e të cilit konstatohet se me vendimin nr. 4660, datë 20.09.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

- *Mos miratimin e lëshimit të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes të paditëses Flavia {...}, si të pambështetur në prova e ligj-Shpenzime gjyqësore ska.*
- *Kundër vendimit lejohet ankim brenda afatit ligjor 5 ditor në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.*
- *Tiranë, më 20.09.2022.*

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 3 (30-2023-46), datë 17.01.2023 ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.4660, datë 20.09.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*
- *Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë*
- *U shpall sot nw Tiranw 17.01.2023*

ii) Vendim nr.388/2 prot., datë 13.11.2023 të Prokurorit për Disiplinën pranë Shkollës së Magjistraturës “*Për arkivimin e ankesës kundrejt kandidatit për magjistrat z. {...}*”.

iii) Vendim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, datë 22.12.2022 “*Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin Nr.12433, të vitit 2022*”

iv) Vërtetim datë 05.12.2023 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

v) Vërtetim nr.12433, datë 20.09.2022 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

44. Në analizë të dokumentacionit të paraqitur nga ana e kandidatit dhe në vijim të procedurës së verifikimit, u vlerësua i nevojshëm kërkimi/administrimi i informacionit shtesë nga Institucionet si më poshtë vijon.

45. Me shkresën nr. 3356 prot., datë 24.06.2024 drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, u kërkua informacion mbi ecurinë dhe statusin e kallëzimit Nr.12508, datë 16.09.2022, të bërë nga shtetasi {...} ndaj shtetases Bitilda Mehmeti, për veprën penale “*Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë*” të parashikuar nga neni 109/1 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

45.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me anë të kthim përgjigjes nr. 14796/1 prot., datë 04.07.2024, protokolluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. 3356/6 prot., datë 05.07.2024, bën me dije se: “... *kallëzimi penal nr. 12508, viti 2022, referuar “për vlerësim” rezulton të jetë mosfilluar me vendimin e datës*

19.01.2023. *Bashkëlidhur po ju dërgojmë kopje të njehsuar me origjinalin të fashikullit penal...*”

45.2. Me anë të shkresës nr. 3356/11 prot., datë 09.07.2024, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Penale), u kërkua informacion është ushtruar e drejta e ankimit nga palët mbi vendimin e datës 19.01.2023 për mosfillimin e procedimit penal nr. 12508, viti 2022, dhe nëse po, informacion mbi ecurinë e tij në gjykatë.

45.3. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me anë të kthim përgjigjes nr. 2349/1 prot., datë 19.07.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3356/13 prot., datë 19.07.2024 informon se: “...nga verifikimet e kryera në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Penale të Gjykatës për periudhën **2022-2024** nuk rezulton që nga shtetasi {...} të jetë bërë ankim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mbi “Vendimin e mosfillimit të procedimit penal Nr.12508/2022”

46. Me shkresën nr. 3356/1 prot., datë 24.06.2024 drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, u kërkua informacion mbi ecurinë dhe statusin e procedimit penal Nr.5219, viti 2023, të bërë nga shtetasi {...} ndaj shtetases {...} ({...}), për veprën penale "Keqtrajtimi i të miturit" dhe "Marrja e padrejtë e fëmijës", parashikuar nga nenet 124/b/2 dhe 127 të Kodit Penal.

46.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me anë të kthim përgjigjes nr. 14795/1 prot., datë 05.07.2024 protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3356/10 prot., datë 09.07.2024 dhe kthim përgjigjes nr. 14795/2 prot., datë 09.07.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3356/9 prot., datë 09.07.2024, informon se: “...Nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve, rezulton se procedimi penal Nr.5219, viti 2023, për veprën penale "Keqtrajtimi i të miturit" dhe "Marrja e padrejtë e fëmijës" parashikuar nga nenet 124/b/2 dhe 127 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetases Flavia {...}, vijon ende në fazën e hetimeve...”

47. Me anë të shkresës nr. 3356/4 prot., datë 09.07.2024, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Penale), u kërkua informacion nëse shtetasja Flavia {...} vazhdon të jetë nën efektin e masës së sigurimit "arrest me burg" në mungesë, të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin Nr.1850/Regj, datë 19.08.2023, si dhe kopje e këtij vendimi.

47.1. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën kthim përgjigje nr. 2176/1 prot., datë 10.07.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3356/12 prot., datë 10.07.2024 dërgoi bashkëlidhur:

i) Kopje të vendimit penal Nr. 1850 Regj. Them datë 19.08.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt caktimin e masës “**arrest me burg**” kundër personit nën hetim {...} {...}, të akuzuar për veprën penale “**Keqtrajtim i të miturit**”

dhe **“Marrja e padrejtë e fëmijës”** të parashikuar nga nenet 124/b/2 dhe 127 i K.Penal, me anë të cilit është vendosur:

1. *Caktimi i masës së sigurimit personal “**arrest në burg” në mungesë për personin nën hetim {...} {...}, e bija e Astrit dhe Lirije, dtl 05.06.1984, lindur e banuese në rrugën “Beqir Rusi”, Tiranë, bazuar në nenin 238 të K.Pr.Penale.***
2. *Urdhërohet Policia Gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.*
3. *Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e njoftimit apo zbatimit të këtij vendimi, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.*

U shpall në Tiranë, sot më datë 19 gusht 2023!

Vendimi mban shënimin e Kryesekretares *“Ky vendim mori formë të prerë pasi nuk u ankimua në datë 24.06.2024”.*

ii) Kopje të vendimit penal Nr. 1472 Regj. Them datë 07.06.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt **“Deklarimi i ikjes së personit nën hetim {...}{...}”**, e dyshuar për veprën penale **“Keqtrajtim i të miturit”** dhe **“Marrja e padrejtë e fëmijës”** të parashikuar nga nenet 124/b/2 dhe 127 i K.Penal, me anë të cilit Gjykata ka vendosur:

1. *Deklarimin e ikjes së personit nën hetim {...}{...} {...}, e dtl 05.06.1984.*
2. *Caktimin e **Znj. Donata Lerpenica**, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, si avokate mbrojtëse e personit nën hetim Flavia Astrit {...}.*
3. *Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet av. Donata Lepenica dhe një kopje tjetër depozitohet në sekretarinë e kësaj Gjykate.*

U shpall në Tiranë sot më datë 07 qershor 2024!

48. Me shkresën nr. 3356/3 prot., datë 24.06.2024, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile), u kërkua informacion mbi çështjen civile me Nr. 9195, me palë paditëse/kërkues: {...}, e paditur: Flavia Kuqi/{...}, me objekt: *“Zgjidhjen e martesës me faj të të paditurës Flavia {...}”*,

48.1. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën kthim përgjigje nr. 4315/1 prot., datë 05.07.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3356/7 prot., datë 08.07.2024, bën me dije se: *“...pranë gjyqtarës Majlinda Dogga vazhdon të jetë në gjykim çështja civile me Nr.9195 Akti, me datë regjistrimi 19.09.2023, me paditës {...} dhe e paditur {...}/ {...}, me objekt: “Zgjidhje martese me faj të të paditurës Flavia {...}”. Në datën 02.07.2024 Gjykata në seancën e veprimeve të pajtimit “Vendosi të shtyjë seancën për t’i lënë kohë palës së paditur të paraqesë taksën e kundërpadisë, si dhe palët të paraqesin provat shkresore të sipërcituara.Seanca do të lihet në datë 25.07.2024, ora 10:30.Palët prezent dhe psikologia morën dijeni...”*

49. Me anë të shkresës nr. 3356/2 prot., datë 24.06.2024, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, u kërkua informacion nëse është ushtruar e drejta e ankimit, ndaj vendimit nr.388/2 prot., datë 13.11.2023, *“Për arkivimin e ankesës kundrejt kandidatit për magjistrat z. {...}”* të Prokurorit për Disiplinën pranë Shkollës së Magjistraturës dhe nëse po, vijueshmëria e tij në gjykatë.

49.1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me shkresën kthim përgjigje nr. 11333/1 prot., datë 02.07.2024, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 3356/5 prot., datë 02.07.2024, informon se: “...pas verifikimit të regjistrave dhe sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, **nuk rezulton** padi e paraqitur nga znj. {...} {...} ndaj Vendimit nr.388/2 prot., datë 13.11.2023, "Për arkivimin e ankesës kundrejt kandidatit për Magjistrat z. {...}”.

50. Për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidatin z. {...} u kërkua informacion nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, e cila e ka dërguar atë me shkresën nr. 2108/1 prot., datë 14.02.2024, protokolluar në Këshill me nr. 611/15 prot., datë 15.02.2024, nga përmbajtja e të cilës nuk rezulton që ndaj kandidatit të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal.

51. Për verifikimin e figurës së kandidatëve, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë dhe të gjithë Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm kanë kryer verifikimin përkatës, të cilat në kohë të ndryshme kanë përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor informacionin për kandidatët që priten të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}. Sipas informacioneve të administruara, rezulton se “... z. {...} nuk ka asnjë çështje të regjistruar apo vendim të dhënë në ngarkim të tij ... ”

52. Së fundi, për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidatin z. {...} u kërkua informacion nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me disiplinën e kandidatit gjatë ndjekjes së programit të formimit fillestar për magjistrat në kushtet kur, sipas nenit 255 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar², kandidati për magjistrat është subjekt i përgjegjësisë disiplinore, ndërsa janë organet e Shkollës së Magjistraturës sipas këtij ligji³ ato që kanë përgjegjësinë e verifikimit të ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore dhe procedimit disiplinor të kandidatëve për magjistrat. Me shkresën nr. 123/1 prot., datë 09.02.2024, protokolluar në Këshill me nr. 611/13 prot., datë 09.02.2024, ndër të tjera, Shkolla e Magjistraturës ka informuar se për kandidatin z. {...}, organi disiplinor nuk ka regjistruar procedim disiplinor dhe kundrejt tij nuk është marrë masë disiplinore.

² “...kandidatët për magjistratë mbajnë përgjegjësi për shkeljet disiplinore, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloren e brendshme të shkollës”.

³ Neni 256, sipas të cilit: “1. Prokurori për Disiplinën, i caktuar në përputhje me nenin 248, pika 1, shkronja "gj", kryen verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore të pretenduara të kandidatëve për magjistratë. Në rast parandalimi ose konflikti të interesave ai përfaqësohet nga Zëvendësprokurori për Disiplinën, i caktuar në përputhje me nenin 248, pika 1, shkronja "gj", të këtij ligji. ...”, si dhe neni 257, sipas të cilit: “1. Komisioni Disiplinor që kryen procedimin disiplinor dhe cakton masën disiplinore është i pavarur dhe i nënshtrohet vetëm ligjit. 2. Në rastin e procedimit disiplinor ndaj kandidatit për magjistrat, Komisioni Disiplinor përbëhet nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës si kryetar, një gjyqtar dhe një prokuror të zgjedhur në përputhje me nenin 247, pika 1, shkronja "d", të këtij ligji, si anëtarë të Këshillit Drejtues, dhe dy kandidatë për magjistratë të zgjedhur me votë të fshehtë nga asambleja e kandidatëve për magjistratë. ...”.

53. Nga verifikimi sërish i kriterit të figurës për kandidatin z. {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidati, të formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015 dhe për ekzistencën ose jo të ndalimeve sipas këtij ligji;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidati, të nënshkuara, të autorizimit për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) ekzistencën ose jo të lidhjeve ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) ekzistencën ose jo të ndonjë të dhëne tjetër në lidhje me sjelljen etike dhe morale të tij, mbi të cilën të ngrihen dyshime për cënim të besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

B.3 Për kriteret e zgjedhshmërisë

54. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkon që kandidati të këtë kaluar sërish verifikimin e figurës, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

55. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 4/1. *Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: ...; ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit*”.

56. Në kuptim të shkaqeve të tjera përjashtuese në lidhje me pasurinë dhe figurën sipas shkronjës “ç”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sa i përket emërimit si magjistrat, vlen të konsiderohen shkaqet e pazgjedhshmërisë si magjistrat.

57. Shkaqet e pazgjedhshmërisë si magjistrat përcaktohen në nenin 66, pika 1, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit: “1. *Statusi i magjistratit mbaron në ditën kur autoriteti kompetent përcakton me vendim shkaqet e pazgjedhshmërisë si vijon: a) kur magjistrati nuk plotëson kriteret e përcaktuara, sipas nenit 28 të këtij ligji; ...*”. Pra, në kuptim të kësaj dispozite, kriteret sipas nenit 28 të ligjit janë në fakt dhe kritere zgjedhshmërie si magjistrat. Po ashtu, kjo dispozitë imponon për Këshillin e Lartë Gjyqësor verifikimin pa u kufizuar në kohë të

shkaqeve të pazgjedhshmërisë si magjistrat, madje edhe atëherë kur statusi i magjistratit është fituar. Ndaj, në kuptim të kësaj dispozite, ndërsa statusi i magjistratit mund të mbarojë kur nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 28 të Ligjit për Statusin, atëherë për të njëjtën arsye ai nuk mund ta fitojë këtë status, duke shërbyer në këtë mënyrë kriteret e përcaktuara nga kjo dispozitë edhe kritere zgjedhshmërie si magjistrat.

58. Neni 28 i Ligjit për Statusin përcakton “*Kriteret e pranimit në formimin fillestar*”. Verifikimi i këtyre kriterëve për kandidatin z. {...}, në përputhje me nenin 30 të Ligjit të Statusit, është bërë në momentin e kandidimit të tij për në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa ai është lejuar të marrë pjesë në provim, ndërkohë që, në përfundim të provimit të pranimit, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, më datë 14.05.2021, ka miratuar listën e renditjes me rezultatet përfundimtare të shpallura nga Komisioni i Provimit me shkrim dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik, të provimit të pranimit për vitin akademik 2021-2022. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati z. Suzan {...}.

59. Gjithsesi, për kandidatin z. {...} është bërë verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës, në rastin e verifikimit të tij nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, referuar Vendimit të tij nr. 321, datë 21.07.2022.

60. Në rastin e verifikimit sërish të disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur në konsideratë diferencën kohore mes momentit të aplikimit për në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës (Shkurt 2021), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve (prill 2021), si dhe momentit kur Këshilli është shprehur për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të tij për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës (korrik 2022). Dhe po ashtu, Këshilli ka mbajtur në konsideratë dhe faktin se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990). Gjithashtu, Këshilli ka mbajtur në konsideratë detyrimin e tij konstant për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

61. Në kuptim të nenit 28 të Ligjit për Statusin, si kritere zgjedhshmërie si magjistrat identifikohen: *a) zotësia për të vepruar; b) shtetësia shqiptare; c) arsimimi; ç) përvoja profesionale; d) gjendja gjyqësore; dh) disiplina në punë; e) anëtarësia në parti politike në*

kohën e kandidimit; ë) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

62. Gjatë verifikimit sërish të kandidatit për Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk ka mbërritur ndonjë njoftim që të jepte shkas kryerjes së një verifikimi të thelluar mbi përmbushjen nga kandidati të kriterëve të zgjedhshmërisë sipas nenit 28 të Ligjit për Statusin, duke mos pasur kështu për kandidatin ndonjë e dhënë e ndryshme nga ato të verifikuara më parë sa i përket kriterëve sipas kësaj dispozite.

III. KONKLUZIONE

63. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

64. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 2, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” të ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Kualifikimin për emërim të kandidatit z. {...}, i diplomuar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2023 - 2024 dhe vijimin e procedurës së emërimit si gjyqtar.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar,

si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR